

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**" ATOM COMPUTERS" SHPK**

Sot, më datë 27/02/2025, u paraqiten personalisht:

- **Znj. Albina Dimoshi**, e datëlindjes 16/08/1998, shtetas shqiptare, lindur ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me nr 033811608 dhe Nr. Personal J85816052V.

te cilet përpiluan këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **"ATOM COMPUTERS" SH.P.K**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

**Forma Ligjore**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare **" ATOM COMPUTERS "** SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **" ATOM COMPUTERS "** SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit **" ATOM COMPUTERS "** SH.P.K dhe me emrin tregtar **ATOM COMPUTERS**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Shitje-Blerje **me pakice te pajisjeve elektronike**, shitje me pakice te **Cisco**, Fortinet, Mikrotik, shitje me pakice te kompjuterave, monitore dhe pajisjeve periferike te kompjuterav sherbime IT, **sherbime konsulence per ndertime network kompjuterik**.

•

**NENI 5**

**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: **Rruga Panajot Pano , Nd11, N19, Yzberisht , Tirane.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

#### **NENI 6**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njqind mije leke) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 100.000 njqind mije leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortaku themelues.

#### **NENI 7**

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare " **ATOM COMPUTERS** " SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më

|                          |                                   |
|--------------------------|-----------------------------------|
| Ortaku themelues :       | Albina Dimoshi                    |
| Numri i kuotave :        | <b>1</b>                          |
| Numri i pjeseve :        | <b>1</b>                          |
| Pjesëmarrja në Shoqëri : | <b>100,00 %</b>                   |
| Lloji i kontributit:     | <b>Ne para</b>                    |
| Vlera e kontributit      | <b>100,000 (njqind mije) leke</b> |

Duke qenë se Kapitali themeltar do të depozitohet në llogarinë e Shoqërisë e cila do të hapet pas regjistrimit në QKB, atëherë ortaku vendos që kjo shume do të paguhet prej tij jo më vonë 3 muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, në llogarinë e shoqërisë tregtare.  
Rregullat e pagesës së kësaj shume janë parashikuar në këtë Statut.

#### **NENI 8**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## **NENI 9**

### **Administratori/ët**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërise do te jete :

- **Znj. Albina Dimoshi** , e datëlindjes 16/08/1998, shtetas shqiptare, lindur ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me nr 033811608 dhe Nr. Personal J85816052V.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## **NENI 10**

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## **NENI 11**

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

## **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

## **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues, u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaket jane njohes te gjuhes shqipe.

### **ORTAKET THEMELUES**

**Albina Dimoshi**

